



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2020:057093

Datë: 27.04.2021

Numri i dokumentit: 01737403

P.nr.65/2020

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjilan - Dega në Kamenicë, gjyqtari Sadri Krasniqi, me sekretaren juridike Tevide Thaqi, në lëndën penale kundër të akuzuarit L.N., me vendbanim në”, për shkak të veprës penale: Kontrabandimi i mallrave, nga neni 311, parag.1, të KPRK-së, sipas aktakuzës së PTH-së nga Gjilani PP.II.nr.226/2020, të dt. 05.05.2020, në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur më 13.04.2021, në prani të Prokurorës së Shtetit Huma Jetishi dhe të akuzuarit L.N., shpalli dhe publikisht komunikoi, ndërsa më datën 27.04.2021 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I a k u z u a r i :

L.N., pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga i ati I. e ëma H., mbiemri i vajzërisë D., i lindur më, në, me vendbanim në me nr. personal, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, prind i një fëmije, ka të kryer shkollën e mesme, i papunësuar, i gjendjes së varfër ekonomike, në bazë të evidencës që disponon kjo gjykatë nuk ka qenë i dënuar më parë për veprë tjetër penale, nuk udhëhiqet procedurë për veprë tjetër penale.

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse,

Më datë 09.02.2020, rreth orës 14:00, në udhëkryqin e rrugës së fshatit Bllatë, komuna e Kamenicës, i pandehuri, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm material për vete, nga Republika e Maqedonisë së Veriut, përmes rrugëve ilegale-malore, në territorin e Republikës së Kosovës, në fshatin Bllatë, ka sjellur aparate të lojërave të fatit, ashtu që, patrulla e policisë, e ka ndalur për kontroll automjetin e markës “.....”, ngjyrë, me tabela të regjistrimit, të cilën e drejtonte i pandehuri, ku i njëjti ishte duke transportuar pesë aparate të lojërave të fatit “.....”, pa numra serik-numra të pa dukshëm dhe pa dokumentacion përcjellës, në këtë mënyrë i pandehuri me veprimet e tij, iu ka shmangur kontrollit doganor, e që sipas vlerësimit të doganës shmangia doganore është 1.117.50 (njëmijë e njëqind e shtatëmbëdhjetë euro e pesëdhjetë cent).

- me ç’rast ka kryer veprën penale: Kontrabandimi i mallrave, nga neni 311, parag.1, të KPRK-së,

Gjykata në bazë të nenit të lartë cekur dhe neneve 4, 38, 39, 43, 69 dhe 70 të KPRK-së, lidhur me nenin 248, 365 dhe 451 të KPPRK-së, të akuzuarin L.N. e,

G J Y K O N

Me dënim gjobe (në të holla) në shumë prej **700 € (Shtatqindë euro)**, të cilin dënim ka për ta paguar në afatin prej 15 dite nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, në të kundërtën, i njëjti dënim do ti zëvendësohet me dënim burgu ashtu që për çdo 20 €, do ti llogaritet nga një ditë burg.

Të akuzuarit L.N., në dënimin e shqiptuar me gjobë, do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej dt. 09.02.2020 e deri më 21.02.2020.

Në kuptim të nenit 311, paragrafi 6 të KPRK-së dhe nenit 115, parag. 2, lidhur me parag. 1 të KPPRK-së, të akuzuarit, i **konfiskohen** pesë aparate të lojërave të fatit, të llojit “....” pa numra serik, si dhe një telefon celular të markës “Samsung” M-10, me SIM kartelë, me numër të telefonit, të sekuestruara përkohësiht sipas Urdhërësës për sekuestrim të përkohshëm të mallit PPr.nr. 18/2020 të datës 11.02.2020, dhe pas plotfuqishmërisë së këtij

aktgjykimi sendet e konfiskuara t'i dorzohen Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, për veprime të mëtutjeshme sipas ligjit.

Pala e dëmtuar Dogana e Republikës së Kosovës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Detyrohet i akuzuari L.N., që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, krejt këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

Njashtu i akuzuari obligohet që në kuptim të nenit 39, paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, të paguaj shumën prej 30 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, me aktakuzën PP.II.nr.226/2020, të dt. 05.05.2020, ka kërkuar që ndaj të akuzuarit: L.N. nga, të fillohet dhe shtjellohet procedura penale, për shkak të veprës penale: Kontrabandimi i mallrave, nga neni 311, parag.1, të KPRK-së, të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata shqyrtoi aktakuzën dhe pas vlerësimit të së njëjtës dhe shkresave tjera të lëndës konstatoi se aktakuza është e bazuar në ligj, andaj duke vepruar sipas të njëjtës, ka caktuar seancë gjyqësore për shqyrtim fillestar kundër të akuzuarit për dat.13.04.2021, në të cilën seancë gjyqësore pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, i akuzuari L.N., ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, njëherit thekson se e pranon fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale.

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjykata pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt, gjykata ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë; se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Andaj, duke u bazuar në të cekurat më lartë, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

- se i akuzuari L.N. me dashje ka kryer veprën penale: Kontrabandimi i mallrave, nga neni 311, parag.1, të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, për të cilën veprë penale, gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj veprë penale dhe se për të njëjtën është edhe penalisht përgjegjës.

Me rastin e vendosjes për llojin dhe lartësinë e dënimit ndaj të akuzuarit për veprën penale të kryer, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të nenit 70 të KPRK-së, ndikojnë në shqiptimin e drejtë dhe meritore të dënimit ligjor. Në veçanti për këtë rast si rrethana lehtësuese për të akuzuarin gjykata pati parasysh pranimin e fajësisë nga i akuzuari, gjendjen e vështirë ekonomike në të cilën jeton, është penduar thellë për veprën penale të kryer, si dhe premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të kryej veprë tjetër penale.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi me gjobë si në dispozitiv të aktgjykimit ndaj të akuzuarit L.N., duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë të akuzuarit.

Gjykata, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim, mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Të akuzuarit L.N., në dënimin e shqiptuar me gjobë, do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej dt. 09.02.2020 e deri më 21.02.2020.

Në kuptim të nenit 311, paragrafi 6 të KPRK-së dhe nenit 115, parag. 2, lidhur me parag. 1 të KPRK-së, të akuzuarit, i **konfiskohen** pesë aparate të lojërave të fatit, të llojit “.....” pa numra serik, si dhe një telefon celular të markës “.....”, me numër të telefonit- të sekuestruara përkohësisht sipas Urdhresës për sekuestrim të përkohshëm të mallit PPr.nr. 18/2020 të datës 11.02.2020, dhe pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi sendet e konfiskuara t’i dorzohen Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, për veprime të mëtutjeshme sipas ligjit.

Pala e dëmtuar Dogana e Republikës së Kosovës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të akuzuarit, gjyqtari i vetëm gjykues, bazuar në nenin 451 paragrafi 1 i KPPRK-së, ka vendosur që të akuzuarin ta detyrojë për ta paguar paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (Njëzetë euro), si dhe 30 € për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përbarimi.

Nga të cekurat më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- DEGA NË KAMENICË,

P.nr. 65/2020 më datë. 27.04.2021

Gj y q t a r i,

Sadri Krasniqi,d.v.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.